



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 41, datë 28.01.2025

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMI PËR OBJEKTIN:

“STRUKTURË APARTHOTEL ME SHËRBIME ME 1, 2, 3, 6 DHE 11 KATE MBI TOKË,
DHE 1 DHE 2 KATE PARKIM NËNTOKË” ME VENDNDODHJE NË RRUGËN “IDRIZ
ALIDHIMA”, BASHKIA SARANDË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “S.E.G-Ahmeti” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Strukturë aparthotel me shërbime me 1, 2, 3, 6 dhe 11 kate mbi tokë, dhe 1 dhe 2 kate parkim nëntokë” me vendndodhje në Rrugën “Idriz Alidhima”, Bashkia Sarandë, me subjekt zhvillues shoqërinë “S.E.G - Ahmeti” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.

KRYETARI


EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 22 / 09 / 2025